



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e martë, në datën 21 dhjetor 2021, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e projektbuxhetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, për vitin 2022. **(Vendimi nr. 97, datë 21.12.2021)**
2. Miratimin e disa ndryshimeve në kërkesën për marrjen e autorizimit të shoqërisë “Vodafone Albania” sh.a., autorizuar për ofrimin e shërbimeve audiovizive. **(Vendimi nr. 98, datë 21.12.2021)**
3. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Bleta” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP (IPTV) “Bleta”. **(Vendimi nr. 99, datë 21.12.2021)**
4. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë, ndryshimin e emrit të subjektit tregtar dhe subjektit audioviziv nga “UTV Education” në “Panorama Tv”, të shoqërisë “Panorama Tv” sh.p.k., licencuar për ofrim shërbimi programi audioviziv”. **(Vendimi nr. 100, datë 21.12.2021)**
5. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Net 3 Digital” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor “Net 3 Digital”. **(Vendimi nr. 101, datë 21.12.2021)**
6. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Elbasan Cable” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Elbasan Cable”. **(Vendimi nr. 102, datë 21.12.2021)**
7. Ndryshimin e vendimit të dënimit me gjobë, nr. 13, datë 01.11.2021, të grupit të inspektorëve të AMA-s, duke ulur masën e sanksionit nga 2 000 000 lekë, në masën 1 000 000 lekë, vendosur ndaj shoqërisë “Tibo” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, mbështetur në rrjet IP (OTT) dhe refuzimin e ankimit administrativ për pjesën tjetër. **(Vendimi nr. 103, datë 21.12.2021)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 21.12.2021